



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorëzuar Received / Delivered	10 - 12 - 2018	8	viti god year
Organ / Njësia Org. / Unit	Nr. Prot. B. Prot. Prot. No.	Shtojca Pulog Appendix	Sasia Kështja Quantity
SKPM/SHK	7528/2018		111



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Nr. 331 /2018
Datë: 15.11.2018

Në mbështetje të nenit 6 paragrafit 1 nënparagrafit 1.3, nenit 20 paragrafit 2, 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 10 të Rregullores Nr. 01/2018 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 3, nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 1.1, nenit 5, nenit 16 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr. 04/2018 për Procedurën e Monitorimit të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil, pasi shqyrtoi raportin me rekomandime për Monitorimin të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Komunën e Prizrenit, Këshilli në mbledhjen e njëzet e tretë (XXIII) të mbajtur më datë 15.11.2018 mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet raporti me rekomandime i Kolegjit të Këshillit lidhur me Monitorimin të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Komunën e Prizrenit.
2. Obligohet Kryetari i Komunës së Prizrenit për zbatimin e rekomandimeve në raport, brenda katër dhjetë e pesë (45) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
3. Raporti me rekomandim i Kolegjit të Këshillit lidhur me Monitorimin të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Komunën e Prizrenit është pjesë e bashkangjitur këtij vendimi.
4. Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas zbatimit të rekomandimeve në pajtim me këtë vendim dhe raportin.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit.

Vendimi i dërgohet:

- Kryetarit të Komunës së Prizrenit;
- Menaxherit të Personelit të Komunës së Prizrenit dhe
- Arkivit të Këshillit.

Eshref SHABANI
Kryetar i Këshillit





REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Punijano / Predato Received / Delivery	10 . 12 2018	8	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org./Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSHCK 7528/2018			1/12

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

RAPORTI I MBIKËQYRJES SË ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TE
LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL

NË

KOMUNËN E PRIZRENIT

PËR VITIN

2017

Prishtinë, 2018

TABELA E PËRMBAJTJES

Hyrje	3
Funksioni i Mbikëqyrjes.....	3
Objektiva dhe metodologjia e mbikëqyrjes.....	3
Fushat e mbikëqyrjes.....	4
Raporti për mbikëqyrjen në Komunën e Prizrenit.....	5
Organizimi i Brendshëm dhe të Dhënat e të Punësuarve.....	7
Procedurat e Rekrutimit dhe të Avancimit.....	7
Procedurat Disiplinore.....	8
Procedurat e Ankesave.....	8
Procedurat e Vlerësimit.....	9
Procedurat e Pushimeve.....	9
Procedurat e Transferimit.....	10
Të dhënat për përfaqësim etnik, gjinor dhe personave me nevoja të veçanta.....	10
Pezullimi, Ndërprerja dhe Përfundimi i Marrëdhënies së Punës.....	11
Papajtueshmëria në mes të ushtrimit të detyrës së nëpunësit civil dhe funksionarit publik.....	11
Të dhënat nëse ndaj nëpunësve civil është duke u zhvilluar procedurë penale ose janë dënuar me vendim të gjykatës.....	11
Trajnimi i Nëpunësve Civil.....	12
Vijimi në Punë, Pagat, Shtesat dhe Kompensimet.....	12
Zbatimi i Rekomandimeve dhe Vendimeve të Këshillit.....	12
Shënimet/komentet/konkluzionet e përgjithshëm për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.....	12

HYRJE

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Këshilli) mbikëqyrë rregullat dhe parimet e shërbimit civil të Kosovës.

Baza ligjore për ushtrimin e funksioneve të Këshillit është Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Ligji nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligji nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative, Rregullorja Nr. 02/2016 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Rregullorja Nr. 03/2016 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Rregullorja Nr. 04/2016 për Procedurën e Mbikëqyrjes së Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Institucionet e Administratës Publike si dhe ligjet dhe aktet nënligjore që ndërlidhen me shërbimin civil.

Këshilli përmes mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve në shërbimin civil angazhohet që të sigurohet një administratë profesionale dhe efikase, sipas standardeve evropiane.

FUNKSIONI MBIKQYRËS I KËSHILLIT

Në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 04/2016 për Procedurën e Mbikëqyrjes së Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Institucionet e Administratës Publike, përmes funksionit të mbikëqyrjes Këshilli bënë mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

Për të ushtruar këtë funksion në mënyrën më të mirë, Këshilli ka miratuar “Udhëzuesin për procedurën e mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil”, mbi bazën e të cilit edhe harton “Planin e Mbikëqyrjes” në kuadër të të cilit përfshihen një numër i Institucioneve të nivelit qendror dhe lokal, si dhe organe të pavarura dhe agjenci qendrore në kuadër të këtyre Institucioneve, plan ky i cili miratohet nga Këshilli në çdo fillim viti.

OBJEKTIVA DHE METODOLOGJIA E MBIKËQYRJES

Objektiva e mbikëqyrjes ka për qëllim monitorimin e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil. Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësisë për realizimin e objektivës sonë kemi zbatuar një kombinim të mostrave sipas gjykimit dhe sipas rastit në përzgjedhjen e dosjeve, dhe jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave me zyrtarët e personelit, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e zhvillimit të procedurave dhe respektimin e legjislacionit të shërbimit civil.

FUSHAT E MBIKËQYRJES

Këshilli, gjatë implementim të mandatit të tij lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, ka përcaktuar fushat të cilat do të jenë pjesë e mbikëqyrjes në kuadër të Divizioneve të Burimeve Njerëzore dhe mekanizmave tjerë të Institucioneve të cilët janë përgjegjës për zbatim të legjislacionit të shërbimit civil.

Në këtë kuadër si pjesë e mbikëqyrjes janë:

- Organizimi i brendshëm dhe të dhënat e të punësuarve;
- Procedurat e rekrutimit dhe të avancimit;
- Procedurat disiplinore;
- Procedurat e ankesave;
- Procedurat e vlerësimit;
- Procedurat e pushimeve;
- Procedurat e transferimit;
- Të dhënat për përfaqësim etnik, gjinor dhe personave me nevoja të veçanta;
- Procedurat e pezullimit, ndërprerjes dhe përfundimit të marrëdhënies së punës;
- Papajtueshmëria në mes të ushtrimit të detyrës së nëpunësit civil dhe funksionarit publik;
- Të dhënat nëse ndaj nëpunësve civil është duke u zhvilluar procedurë penale ose janë dënuar me vendim të gjykatës;
- Trajnimi i nëpunësve civil;
- Vijimi në punë, pagat, shtesat dhe kompensimet;
- Zbatimi i rekomandimeve dhe vendimeve të Këshillit;
- Shënimet/Komentet/Konkluzionet e Përgjithshme për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil

RAPORT PËR MBIKËQYRJEN E ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL NË KOMUNËN E PRIZRENIT

Këshilli, gjatë procesit të mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil në Komunën e Prizrenit për të vlerësuar drejtë në mënyrë të paanshme dhe të saktë gjendjen e ligjshmërisë së veprimeve të ndërmarra nga Komuna e Prizrenit përveç mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë që ka zhvilluar gjatë realizimit të vizitës në Komunën e Prizrenit me datë 21.06.2018, në prezencë të Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore, si mostra për shqyrtim ka marr një mori të kopjeve të dokumenteve relevante, si në vijim:

- Vendimin për Organizimin e Brendshëm, Sistematizimin, Përshkrimin dhe Klasifikimin e Vendeve të Punës në Administratën e Komunës së Prizrenit të datës 15.11.2012;
- Vendimin më Nr. 01-116-49761 të datës 27.04.2017 për formimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave;
- Vendimin me Nr. 01-116-123916 të datës 07.09.2017 për formimin e Komisionit Disiplinor;
- Dosjen e Nëpunësit për pozitën “Bashkëpunëtor Profesional-Arkitekt”;
- Dosjen e nëpunësit për pozitën “Udhëheqës i Sektorit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural”;
- Dosjen e nëpunësit civil për pozitën “Zyrtar i Personelit”;
- Aktvendimin me Nr. 01-111-13065 të datës 24.01.2018 të Kryetarit të Komunës për anulim të konkurseve, Njoftimin e datës 31.01.2018, E-mail i datës 04.01.2018, 29.12.2017 dhe Njoftimi i datës 29.12.2017;
- Konkursin për shërbime të veçanta i datës 24.04.2017 dhe 21.07.2017 dhe e tërë procedurën për marrëveshje për shërbime të veçanta;
- Njoftimin e datës 25.09.2017 nga Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, Ankesën e datës 05.09.2017 për Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave;
- Vendimin e datës 15.12.2017 për vendosje të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave lidhur me ankesën e datës 06.12.2017;
- Mostrat e pushimeve mjekësore;
- Formularin për vlerësimin e punës provuese i datës 21.06.2017 për pozitën “Zyrtar për Biznese” dhe “Zyrtar për Promovim të Turizmit”;
- Aktvendim me Nr. 02-131-131025/01 i datës 20.09.2017 për lejimin e shfrytëzimit të pushimit pa pagesë, Kërkesën për pushim pa pagesë e datës 20.09.2017;
- Aktvendim e datës 22.09.2017 për lejimin e shfrytëzimit të pushimit pa pagesë, Kërkesën për pushim pa pagesë e datës 21.09.2017;
- Aktvendim me Nr. 02130-139904/01 i datës 07.11.2017 për lejimin e shfrytëzimit të pushimit të lehonisë, Fletëdaljen nga Spitali Rajonal i Prizrenit datë 10.11.2017;
- Dosjen e Procedurës së Rekrutimit për pozitën “Zyrtar për Arkiv”;
- Vendim me Nr. 01-112-163882 i datës 30.11.2017 për transferimin e përhershëm të nëpunësit civil; Ndryshim dhe plotësimi i aktit të emërimit i datës 30.11.2017;
- Vendim me Nr. 01-112-159023 i datës 17.11.2017 për transferimin e përhershëm të nëpunësit civil; Ndryshim dhe plotësimi i aktit të emërimit i datës 17.11.2017; Kërkesën e datës 10.11.2017;
- Vendim me Nr. 01-112-123633 i datës 06.09.2017 për transferimin e përhershëm të nëpunësit civil; Ndryshim dhe plotësimi i aktit të emërimit i datës 06.09.2017; Kërkesën e datës 28.03.2017 dhe 19.05.2017;
- Vendim me Nr. 01-112-163887 i datës 30.11.2017 për transferimin e përhershëm të nëpunësit civil; Ndryshim dhe plotësimi i aktit të emërimit i datës 30.11.2017;

- Aktvendim me Nr., 01-030-133061 i datës 25.09.2017 për pezullim parandalues me 50% të pagës; Njoftimi i datës 25.09.2017, Aktakuzën e datës 31.08.2017;
- Vendim me Nr. 01-112-002100 i datës 04.01.2018 për pezullim të marrëdhënies së punës në shërbimit civil, kërkesën e datës 05.12.2017;
- Vendim me Nr. 01-112-009150 i datës 17.01.2018 për pezullim të marrëdhënies së punës në shërbimit civil, kërkesën e datës 15.01.2018;
- Vendim me Nr. 01-112-009152 i datës 17.01.2018 për pezullim të marrëdhënies së punës në shërbimit civil, kërkesën e datës 16.01.2018;
- Vendim me Nr. 01-118-50219 i datës 28.04.2017 për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me dorëheqje, Njoftimin e datës 06.04.2017;
- Vendim me Nr. 01-118-16327 i datës 31.01.2018 për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me dorëheqje;
- Vendim me Nr. 01-118-122616 i datës 05.09.2017 për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me dorëheqje, Kërkesë për dorëheqje e datës 03.08.2017;
- Aktvendim me Nr. 01-118-155864 i datës 09.11.2017 për përfundimin e marrëdhënies së punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, Listën e pagave nëntor 2017 dhe janar 2018;
- Aktvendim me Nr. 01-118-64790 i datës 29.05.2017 për përfundimin e marrëdhënies së punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, Listën e pagave maj dhe qershor 2017;
- Aktvendim me Nr. 01-118-76157 i datës 19.06.2017 për përfundimin e marrëdhënies së punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, Listën e pagave qershor dhe korrik 2017;
- Plani i trajnimeve në Komunën e Prizrenit.

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, duke u bazuar në provat dhe dëshmitë e shqyrtuara për fushat e mbikëqyrjes të përfshira në “pyetësor”, ka konstatuar të gjeturat dhe ka dhënë rekomandimet përkatëse për zyrtarët përgjegjës të institucionit si në vijim:

1. ORGANIZIMI I BRENDSHËM DHE TË DHËNAT E TË PUNËSUARVE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë vizitës që ka bërë në Komunën e Prizrenit më datë 21.06.2018, ka konstatuar që ky institucion ka në fuqi Vendimin për Organizimin e Brendshëm, Sistematizimin, Përshkrimin dhe Klasifikimin e Vendeve të Punës në Administratën e Komunës së Prizrenit të datës 15.11.2012 i cili është duke u zbatuar, është përfunduar edhe klasifikimi i vendeve të punës. Në këtë institucion janë të punësuar 255 nëpunës civil pa stafin e drejtorëve, zëvendës drejtorëve të shkollave, QKMF dhe Qendrës për Punës Sociale, ndërsa pozita të lira janë 16.

Gjatë vizitës Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil ka shqyrtuar dosjet e personelit dhe ka konstatuar se janë shqyrtuar pesë (5) dosje të nëpunësve civil ndërsa si kopje janë marrë tri (3) dosje atë për pozitën “Zyrtar i Personelit”, “Udhëheqës i Sektorit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural” dhe “Bashkëpunëtor Profesional-Arkitekt” dhe në bazë të shqyrtimit të dosjeve është konstatuar që dosjet e personelit kanë qenë të kompletuara ashtu siç përcaktohet me dispozitat e nenit 4 dhe 5 të Rregullores Nr. 03/2011 mbi Dosjet dhe Regjistrin Qendror të Nëpunësve Civilë.

Ushtruesit e detyrës: Kolegji duke u bazuar në dëshmitë e ofruara ka konstatuar se në këtë institucion nuk ka pasur asnjë pozitë me ushtrues detyre..

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

2. PROCEDURAT E REKRUTIMIT DHE TË AVANCIMIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komuna e Prizrenit ka përgatitur planin e personelit dhe gjatë vitit 2017, janë zhvilluar shtatëmbëdhjetë (17) procedura të rekrutimit/avancimit dhe në bazë të shqyrtimit të dosjeve kemi konstatuar që disa procedura (5) janë anuluar me vendim të Kryetarit të Komunës dhe një është anuluar nga Zyra e Personelit pasi që nuk ka pas kandidat pasi i njëjta procedurë ka qenë e brendshme/avancim. Po ashtu në këtë institucion janë lidhur pesëdhjetë e një (51) kontrata me marrëveshje për shërbime të veçanta të cilat janë zhvilluar pa procedura nuk janë tejkaluar afatet ndërsa disa prej tyre janë lidhur për pozita të shërbimit civil. Pas analizimit të procedurave të rekrutimit dhe kontratave për marrëveshje për shërbime të veçanta janë konstatuar këto të gjetura:

E GJETURA 1: Kolegji për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të dosjeve respektivisht Aktvendimit me Nr. 01-111-13065 të datës 24.01.2018 të Kryetarit të Komunës së Prizrenit për anulimin e konkurseve të shpallura në vitin 2017 për pozitat e shërbyesve civil (Udhëheqës i Sektorit Ligjor, Përfaqësues Ligjor i Komunës, Zyrtar për Emergjencë, Zyrtar për Komunitete dhe Mundësi të Barabarta, Inspektor i Ndërtimit), ka konstatuar që këto procedura të rekrutimit janë anuluar me arsyetimin se për shkak të afateve të ngushta kohore për marrje të vendimeve, rrjedhimisht në bazë të provave të lëndës nga Zyra e Personelit ka propozuar formimin e Komisioneve Përzgjedhëse të Shërbimit Civil sipas Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil por të njëjtat vendime nuk janë nënshkruar nga Kryetari i mëparshëm i Komunës së Prizrenit, por Kryetari i sapo zgjedhur i Komunës në bazë të e-mailit të datës 29.12.2018 për Udhëheqësin e Personelit ka njoftuar që nuk do të nënshkruaj këto vendime pasi që procedurat kanë filluar në kohën e kryetarit të kaluar, mbi këtë bazë Kolegji konstaton që procedurat e rekrutimit nuk duhet të mbesin peng i ndërrimit të kryetarëve të komunës apo e zgjedhjeve pasi që nëpunësit civil kryejnë punët e tyre në bazë të legjislacionit për shërbimin civil, sepse Komisionet Përzgjedhëse të Shërbimit Civil lidhur me procedurën e rekrutimit kryejnë detyrën në bazë të kompetencave të tyre të përcaktuara me nenin 7 paragrafin 7 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe në mënyrë të paanshëm sipas Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

REKOMANDIMI 1:

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës së Prizrenit, që me rastin e anulimit të procedurave të rekrutimit të njëjtat të bëhen duhet u bazuar në dispozitat ligjore dhe të jepen arsye lidhur me anulimin sipas Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe akteve nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

E GJETURA 2: Kolegji për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të dosjeve të punësuarve me marrëveshje për kryerjen e shërbimeve të veçanta, ka konstatuar se Komuna e Prizrenit për vitin 2017 ka pasur të angazhuar pesëdhjetë e një (51) të punësuar me marrëveshje për shërbime të veçanta ku disa prej tyre si (për pozitën Zyrtar për Shërbime me Qytetar), kanë qenë të angazhuar në pozitën e nëpunësve civil.

Kolegji ka konstatuar që në bazë të nenit 12 paragrafit 1 nënparagrafit 1.1 dhe 1.2 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ekzistojnë dy kategori të të punësuarëve: „pozitat e nëpunësve civilë të karrierës dhe pozitat e nëpunësve civilë të jo karrierës”.

Në kuptim të kësaj dispozite, pozitat e nëpunësve civil të karrierës apo të jo karrierës, nuk mund të plotësohen me nëpunës me kontrata për marrëveshje për shërbime të veçanta.

REKOMANDIMI 2:

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës së Prizrenit, që me rastin e lidhjes së Kontratave me marrëveshjeve për shërbime të veçanta duhet pasur parasysh që të njëjtat nuk mund të lidhen marrëveshje të tilla por duhet ndjekur procedurat e parapara me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe akteve nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

3. PROCEDURAT DISIPLINORE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komuna e Prizrenit në bazë të Vendimit me Nr. 01-116-123916 të datës 07.09.2017 ka të themeluar Komisionin Disiplinor i cili është i themeluar me tre (3) anëtar të përhershëm me mandat dy (2) vjeçar që është në pajtim me nenin 70 paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, në bazë të vlerësimeve në këtë institucion nuk është zhvilluar asnjë procedurë disiplinore.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

4. PROCEDURAT E ANKESAVE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komuna e Prizrenit në bazë të Vendimit me Nr.01-11649761 të datës 27.04.2017 ka të themeluar Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i cili është i themeluar me tre (3) anëtar të përhershëm me mandat dy (2) vjeçar, në bazë të vlerësimeve në këtë komisioni gjatë vitit 2017 janë parashtruar 14 ankesa, për të cilat përveç një ankesë të tjerat janë vendosur nga komisioni. Lidhur me këtë kemi konstatuar këtë të gjetur:

E GJETURA 1: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të dosjeve, kemi konstatuar që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave lidhur me ankesën e datës 05.09.2017 më date 25.09.2017 ka nxjerr Njoftim me të cilin ka njoftuar ankuesin lidhur me ankesën, rrjedhimisht është konstatuar që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave ka qenë i obliguar të nxjerr Vendim siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit për Procedurën Administrative, Ligjit Nr.-03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenin 9 paragrafin 4 të Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, sepse në asnjë formë Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave nuk i lejohej të nxjerr njoftim por që lidhur me ankesat e ankuesve duhet të vendos me vendim.

REKOMANDIMI 1:

Rekomandojmë Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prizrenit që me rastin e shqyrtimit të ankesave të ankuesve të nxjerr vendim në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi të Ligjit Nr.-03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, e jo të nxjerr njoftim..

5. PROCEDURAT E VLERËSIMIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komuna e Prizrenit ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë për të gjithë nëpunësit civil dhe nuk ka nëpunës civil për të cilin nuk është kryer vlerësimi i rezultateve në punë ndërsa që të gjithë nëpunësit civil janë vlerësuar vlerësimi është bërë brenda afatit ligjor. Në vitin 2017 për 2 nëpunësi civil është kryer vlerësimi i periudhës provuese, në këtë rast lidhur me vlerësimin e periudhës provuese kemi konstatuar këtë të gjetur:

E GJETURA 1: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se për dy (2) nëpunës civil është kryer vlerësimi i periudhës provuese dhe në bazë të dosjeve kemi marr dy mostra atë për pozitën “Zyrtar për Biznese” dhe “Zyrtar për Promovimin e Turizmit” dhe kemi konstatuar se kjo pozitë është rekrutuar në vitin 2016 dhe kandidatëve të përzgjedhur Akt Emërimit i janë lëshuar më datë 30.06.2016, ndërsa formulari për vlerësimin e punës provues i është lëshuar më datë 21.06.2017 me çka nënkuptohet se vlerësimi i periudhës provues nuk i është bërë 40 ditë para përfundimit të periudhës provuese ashtu siç përcaktohet me dispozitat e nenit 9 paragrafit 2 të Rregullores Nr. 02/2011 për Punën Provuese të Nëpunësve Civilë.

REKOMANDIMI 1:

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës së Prizrenit, që të ndërmerr masat që në të ardhmen për të gjitha vlerësimet e periudhës provuese të bëhen në pajtim me afatet dhe hapat e përcaktuara me dispozitat e Rregullores Nr. 02/2011 për Punën Provuese të Nëpunësve Civilë.

6. PROCEDURAT E PUSHIMEVE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komuna e Prizrenit evidencën e pushimeve të nëpunësve civil e mban në kopje fizike dhe elektronike, 79 nëpunës kanë realizuar pushimin mjekësor dhe në dosje kanë qenë të vendosura shenjat mjekësore, dy (2) nëpunës civil ka realizuar pushimin pa pagesë dhe në bazë të shqyrtimit të dosjes ka qenë kërkesa për pushim si dhe vendimi siç përcaktohet me dispozitat e Rregullores Nr. 06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civilë, po ashtu një (1) nëpunës civil kanë realizuar pushimin lehonisë dhe në bazë të shqyrtimit të dosjes kemi konstatuar këtë të gjetur:

E GJETURA 1: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të Vendimit me Nr. 02-130-139904/01 të datës 07.11.2017 për lejimin e shfrytëzimit të pushimit të Lehonisë për nëpunësen civile për pozitën “Zyrtare e Gjendjes Civile”, ka konstatuar se në këtë vendim është përcaktuar mënyra e shfrytëzimit që gjashtë (6), në bazë të kësaj Kolegji vlerëson që tek vendimi për shfrytëzimin e pushimit të lehonisë duhet specifikohet sipas nenit 12 paragrafit 2 nënparagrafit 2.1, 2.2 dhe 2.3 të Rregullores Nr. 06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civilë.

REKOMANDIMI 1:

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës së Prizrenit, që me rastin e nxjerrjes së vendimeve për pushime të lehonisë, të veprohet në pajtim me dispozitat e nenit 12 të Rregullores Nr. 06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civil.

7. PROCEDURAT E TRANSFERIMIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komuna e Prizrenit, gjatë vitit 2017 ka pasur katër (4) transferime të përhershme të cilat kanë qenë të brendshme për të cilat janë respektuar procedurat ligjore sipas Rregullores Nr. 06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civilë.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

8. TË DHËNAT PËR PËRFAQËSIM ETNIK, GJINOR DHE PERSONAVE ME NEVOJA TË VEÇANTA

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komuna e Prizrenit, ka të punësuar 255 nëpunës civil prej tyre 200 janë shqiptar, 1 serb, 30 boshnjak, 23 turq dhe 1 romë, prej 255 të punësuar nëpunës civil 87 janë të punësuar femra ndërsa 168 janë meshkuj ndërsa në këtë komunë ka vetëm tre (3) nëpunës civil të punësuar nga persona me aftësi të kufizuara. Në bazë të vlerësimit të të dhënave kemi konstatuar këto të gjetura:

E GJETURA 1: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se prej 255 nëpunësve civil të punësuar në Komunën e Prizrenit, 87 prej tyre janë femra ndërsa 168 janë meshkuj, çka nënkupton se nuk ka numër të barabartë të punësuarve në aspektin gjinor ashtu siç përcaktohet me dispozitat e nenit 6 paragrafit 8 të Ligjit Nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore.

REKOMANDIMI 1:

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës së Prizrenit, që të ndërmerr gjitha veprimet për zbatimin e dispozitave të nenit 6 paragrafit 8 të Ligjit Nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore

E GJETURA 2: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se prej 255 nëpunësve civil të punësuar në Komunën e Prizrenit, vetëm tre (3) prej tyre janë të punësuar nëpunës civil nga personat me aftësi të kufizuara, me çka nënkuptohet se nuk është respektuar dispozita e nenit 12 paragrafit 2 të Ligjit Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, pasi që për çdo 50 të punësuar në shërbim civil një duhet me qenë person me nevojë të veçanta.

REKOMANDIMI 2:

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës së Prizrenit, që të ndërmarr të gjitha veprimet për zbatimin e nenit 12 të Ligjit Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara pasi që çdo punëdhënës është i obliguar të punësojë një person me aftësi të kufizuara në çdo pesëdhjetë (50) punëtor.

9. PEZULLIMI, NDËRPRERJA DHE PËRFUNDIMI I MARRËDHËNIES SË PUNËS

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Komunën e Prizrenit, pesë (5) nëpunës civil kanë bërë pezullimin e dakorduar të marrëdhënies së punës në shërbimin civil pasi që kanë marrë pozita politike dhe në bazë të dosjeve janë vendimet si dhe kërkesat ashtu siç përcaktohet me dispozitat ligjore në fuqi të legjislacionit për shërbimin civil. Në bazë të vlerësimit të dosjeve dy nëpunës civil ka shfrytëzuar pushim pa pagesë, ndërsa një nëpunës civil është pezulluar me 50% të pagesë dhe ende është në procedurë penale pasi ndaj tij është ngritur Aktakuzë. Tre (3) nëpunës civil i është ndërprerë marrëdhënia e punës pasi ka dhënë dorëheqje dhe në këtë rast janë respektuar procedurat ligjore. Po në bazë të vlerësimit të dosjeve është konstatuar që nëntë (9) nëpunësve civil i është përfunduar marrëdhënia e punës për shkak të arritjes së pensionimit të cilëve i është bërë pagesa e një page të njëhershme në pajtim me legjislacionin në fuqi, ndërsa nuk ka asnjë nëpunës civil që i është përfunduar marrëdhënia e punës për shkak (ushtrimi të detyrave për arsye shëndetësore, përfundimit të afatit për punësi me afat të caktuar) një nëpunësi civil i është përfunduar marrëdhënia e punës pasi që është dënuar nga gjykata me vendim të formës së prerë për mbajtje të burgut efektiv për gjashtë (6) muaj e më tepër ndërsa dy nëpunësve civil i është përfunduar marrëdhënia e punës për shkak të vdekjes dhe familjes i është bërë pagesa në pajtim me legjislacionin.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

10. PAPAJTUESHMËRIA NË MES TË USHTRIMIT TË DETYRËS SË NËPUNËSIT CIVIL DHE FUNKSIONARIT PUBLIK

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Komunën e Prizrenit nuk ka asnjë nëpunës civil i cili në të njëjtën kohë mbanë pozitë të nëpunësit civil dhe ndonjë post publik.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

11. TË DHËNAT NËSE NDAJ NËPUNËSVE CIVIL ËSHTË DUKE U ZHVILLUAR PROCEDURË PENALE OSE JANË DËNUAR ME VENDIM TË GJYKATËS

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Komunën e Prizrenit, ndaj një (1) nëpunësi civil është duke u zhvilluar ndonjë procedurë penale dhe i cili është në pezullim parandalues por ende nuk është vendosur me vendim të gjykatës.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

12. TRAJNIMI I NËPUNËSVE CIVIL

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komuna e Prizrenit respektivisht zyra e personelit, ka përgatitur planin e trajnimeve në të cilin përfshihen edhe trajnimet, por dhe të cilat trajnime janë marrë parasysh nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike dhe 29 nëpunës civil kanë ndjekur trajnimet, ndërsa nuk ka asnjë nëpunës që ka ndjekur trajnimet me pagesë.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

13. VIJIMI NË PUNË, PAGAT, SHITESAT DHE KOMPENSIMET

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komuna e Prizrenit, vijimin në punë nuk e mban në formë elektronike. Po ashtu në bazë të shqyrtimit të listës së pagave konstatohet se të gjitha pagat realizohet në pajtim me akt emërimet ndërsa përveç IT-së dhe shtesa e shërbimit civil nuk aplikohet asnjë lloj tjetër kompensimi në Komunën e Prizrenit.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

14. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE DHE VENDIMEVE TË KËSHILLIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komuna e Prizrenit, gjatë vitit 2017 ka pranuar 24 vendime të Këshillit ku vetëm dy prej tyre ka pas për obligim të zbatohet dhe i ka zbatuar, ndërsa Komuna e Prizrenit në vitin 2017 është monitoruar për vitin 2016 dhe është dhënë dhjetë (10) rekomandime prej tyre pesë janë adresuar ndërsa pesë nuk janë adresuar.

15.SHËNIMET/KOMENTET PËR MIBKËQYRJEN E ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL

Kolegji i Këshillit gjatë shqyrtimit të të dhënave të dosjeve për fushat e mbikqyrjes, ka konstatuar shtatë (7) të gjetura dhe ka dhënë shtatë (7) rekomandime.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rekomandon menaxhmentin e lartë të Komunës së Prizrenit, që **gjetjet me rekomandimet** e dhëna në këtë raport t'i adresoj dhe së bashku me njësitë përgjegjëse të sigurojë që të ketë zbatim të plotë të legjislacionit për shërbimin civil, sidomos duke pasur një fokus të veçantë për fushat për të cilat janë evidentuar shkelje dhe lëshime në zbatimin e procedurave dhe legjislacionit për shërbimin civil.

I dërgohet:

- Kryetarit të Komunës së Prizrenit;
- Menaxherit të Personelit në Komunën e Prizrenit dhe
- Arkivit të KPMSHCK

Gjylinaze GOLA

Kryetare e Kolegjit



Avdy BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional